



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 92, Datë 02.04.2026

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ELENERGJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 961/1 prot., datë 01.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 284, datë 06.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë për plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 340, datë 23.12.2025, vendosi të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k., duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve, pra brenda datës 24.03.2026, të depozitojë në ERE qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për korrigjimin e kapacitetit të instaluar dhe dokumentacionin tjetër të munguar të aplikimit. Ky vendim iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 2725/9 prot., datë 29.12.2025.
- Më pas, nëpërmjet e-mailit të datës 24.03.2026, dhe shkresës së protokolluar në ERE me nr. 964/1 prot., datë 26.03.2026, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion/informacion plotësues të aplikimit.
- Me depozitimin e dokumentacionit përkatës nga shoqëria brenda afatit të përcaktuar në vendimin e bordit nr. 340/2025, rezulton se ka rënë kushti i pezullimit e si e tillë vlerësohet se duhet të vijohet me heqjen e tij.

## Heqja e pezullimit dhe zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja e bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë për licencim, me qëllim zhvillimin e komunikimit në lidhje me: informacionin/dokumentacionin përkatës nëse ka filluar ndërtimi i HEC-it brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së aktuale, përndryshe depozitimim e një VNM-je të re; depozitimim e dokumentacionit të mbështetjes financiare edhe për vlerën e mbetur të investimit; si dhe saktësimin në lidhje me datën e parashikuar për fillimin e operimit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin si më sipër brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit nr. 340 datë 23.12.2025, *“Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.*
2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtrinë në Qarkun e Elbasanit.
3. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ELENERGJI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**